



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142; 22268141

Nr. 1750 Prot.

Tiranë, më 31.10.2017

**V E N D I M**

**Nr. 220, datë 31.10.2017**

***"Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 88, datë 18.04.2017, 'Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017'"***

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 88, datë 18.04.2017, të Komisionerit,

**VENDOSA:**

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 88, datë 18.04.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017".
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

1. **Enkelejda Hebibasi** Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
2. **Stela Ndoka** Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

3. **Migena Haznedari** Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
3. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt dhe grumbullimin e të dhënave që materializojnë zbatimin e vendimit në datat **8 dhe 9 Nëntor 2017**.
4. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Relacioni duhet të përpilohet deri në datën **12.12.2017**. Më pas do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohet vendimi për përmbylljen e procesit, brenda datës **18.12.2017**.
5. Vendimi përfundimtar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e verifikimit do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur, Bashkisë Tepelenë dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të verifikimit me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë  
22268142

Tel 04 22268141;

Nr. 1750/1 Prot.

Tiranë, 31.10.2017

**M I R A T O H E T**

**Pranvera STRAKOSHA**

**KOMISIONER**

**PROGRAM VERIFIKIMI**

*"Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 88, datë 18/04/2017, 'Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017'".*

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** Bashkia Tepelenë
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit paralajmërues Nr. 88, datë 18.04.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Rregullorja "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 4. Afati i verifikimit:** Verifikimi do të kryhet në institucion në datën **08.11.2017** dhe do të përfundojë më datë **09.11.2017**.
- 5. Procedura që do të ndiqet:** Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe

personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

**1. Enkelejda Hebibasi** Drejtor, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënie me Jashtë

**6. Grupi i punës:** **2. Stela Ndoka** Specialist

**3. Migena Haznedari** Specialist

**7. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:**

Në përfundim të procesit të verifikimit do të përgatitet relacioni përkatës nga Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtuara në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do t'i dërgohet institucionit (*nëse vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar*).

## DREJTIMET E VERIFIKIMIT

**I.** Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin Nr. 88, datë 18.04.2017, "*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017*", nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:

- 1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë të anulojë aktin administrativ nr. 342, datë 01.11.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin "Drejtor në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative", në Bashkinë Tepelenë.*
- 2. Pozicioni në fjalë duhet të plotësohet me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.*
- 3. Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të përbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV "Pranimi në shërbim civil", të*

ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike.

4. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tepelenë, të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

**Aneks i programit:** Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

- II. Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.
  1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
  2. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të verifikimit.

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE  
DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

**Enkelejda HEBIBASI**